



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0833

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P. “Wenda”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit në FSSH” me numër të prokurimit 206-24-7197-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën: 29/10/2024, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si e palejuar, ankesa e N.N.P. “Wenda” me nr. të protokollit 2024/0833, e datës 12/09/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit në FSSH”, me numër të prokurimit 206-24-7197-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”.

II. Lejohet, autoritetit kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit në FSSH”, me numër të prokurimit 206-24-7197-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III.Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.07.2024, “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit në FSSH” me numër të prokurimit 206-24-7197-2-2-1. Ndërsa

me datën 30.08.2024 AK ka publikuar Raporti i vlerësimit të tenderëve të Autoritetit Kontraktues për shpërbllim me kontratë.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 35,000.00 €.

Me 01.09.2024 OE N.N.P. "Wenda" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.09.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.P. "Wenda" me nr. 2024/0833 lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit në FSSH" me numër të prokurimit 206-24-7197-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.P. "Wenda" janë parashtruar si në vijim:

AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, me date 30.09.2021, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, na njofton/dergon letrën standarde për tenderuesin e pasukseshem, që do thote se AK - ZPP me kete rast ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, duke mos dhene nje arsyetim te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-së.

Prandaj ne po japim arsyetimin - pretendimet tona me fakte dhe prova se AK - ZPP nuk ka respektuar koistencen vendimin e PSH, lidhur me cmimet jo normalisht te uleta, mbrojtjen e punetoreve ashtu sic e kerkon neni 31 i LPP-se, duke shkelur dispozitat ligjore te LPP-se si në vijim:

Pretendimi nr. 1: *"Mirëpo, krejt ky arsyetimi i dhene nga AK - ZPP MSH ne vendimin B058 dhe letrat standard është jo i drejt, jo profesional dhe i ndikuar ne nga ngjarje dhe rrethana te cilat janë jashtë kontroilit nga AK, por kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 7, 52, 56, 59, dhe 60 te LPP-se, sepse bazuar ne faktet dhe provat te cilat jene ne platformën elektronike e-prokurim, ku ne m'erastin e pergjigjies ne sqarime permes letres standarde te dates 19.08.2024 i kemi arsyetuar*

duke bashkangjitur edhe analizen financiare te detjuar dhe bazuar ne fakte dhe argumente per secilen kerkes ne ANEKSIN 1 dhe ne pajtim me kerkesen tek kerkesat teknike profesional neni 9.1 & 9.2 te FDT-se ku AK ka kerkuar pagën minimale neto 330 euro sipas Ligjit të Punës, qe dot e thote se AK - ZPP me rastin e vlerësimit per kete AP ka vepruar ne kundërshtim me kerkesat e percaktuar vete ne dosje tenderit dhe ne aneksin 1 te FDT-se ku jane kerkuar si ne vijim: Numri i përgjithshëm i punëtorëve të cilët do të punojnë nga 8 orë në ditë do të jenë 2 (dy), do të jenë pastrues, ndërsa 1 (një) ose më shumë do të jetë mirëmbajtës sipas kërkesës së AK (kurdo që paraqitet nevoja) e mirëmbajtjes higjienike dhe teknike, sanitare - dhe shtim të stafit sipas nevojës së AK pa pasur nevojë për mjete financiare shtesë. 2.10 Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të aplikon ligjin për mbrojtje nëpunë ne tërësipra te: •Siguron uniformat adekuate me mbishkrimet e kompanisë, për të gjithë punëtorët e tij •Siguron veglat dhe mjetet personale për punëtorët e tij •Siguron veglat dhe pajisjet për kryerjen e të gjitha punëve të nevojshme individuale dhe grupore për realizimin e suksesshëm të mirëmbajtjes higjienike, akomodimeve, bartjeve, pastrimit e fasadave kulmeve, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërimit etj •si dhe kërkesa te tjera e te gjitha ne harmoni me obligimet kontraktuese dhe me ligjin e punës. Vërejtje: OE duhet të sjell dëshmi së është duke e zbatuar kontratën përpaguesën e punëtorëve kurdo që AK e kërkon. 6. ORARI I PUNËS 6.1 Orari i rregullt i punës do të jetë prej orës (7.00-15.00) për çdo ditë (e Hënë - e Premte). MATERIALI PËR MIRËMBAJTJE HIGJIENIKE Materialin harxhues për realizimin e mirëmbajtjes higjienike duhet ta siguroj vete kompania. I tërë materiali duhet të jete i kualitetit të lartë dhe klasit të parë. Ofruesi i shërbimeve, para se të filloj aplikimin e materialit, duhet sjellur mostrat për aprovim me shkrim nga AK. Pa aprovimin e materialit nga AK, nuk lejohet përdorimi i të njëjtit për mirëmbajtje higjienike. Minimumi i materialeve të nevojshme për pastrim të cilat Ofruesi i shërbimeve duhet siguruar pandërprerë dhe në sasi të mjaftueshme pavarësisht nga shpenzimi — harxhimi i tyre janë: •Letër tualeti, dy-shtresore e bardhë e kualitetit të lartë •Letër për duar e trashë, e bardhë, e gjerë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë, varësisht nga mekanizmat e instaluar për mbajtjen e letrës, •Sapun të lëngshëm •Dezodorant për urinare, tableta dezinfektuese, plastika - goma të shpuara •Sapun dezodorant (përfshirë edhe shportën) për guaca •Dezinfektues të tualeteve •Dorëza plastike për pastruesit •Detergjent për pastrimin e dritareve •Detergjent për pastrimin e dyshemesë •Detergjent për pastrimin e tepihëve •Qeska për të gjitha llojet e kontejnerëve - shportave të mbeturinave •Qeska për shportat e letrave •Dezodorans për kabinete, zyre, salla, •Detergjent për pastrimin e Pllakave •Kovë për pastrimin e dyshemesë •Makina për pastrim dhe lustrim të pllakave të mermerit - granitit •Fshesë elektrike pa zhurmë me pjesë të përbërëse •Kripë për shkrirjen e borës, akullit, •Kripë me rërë për shkrirjen e borës, akullit, •Fshesa për kopsht •Brusha të ndryshme për pastrime të tualeteve, •Vegla të ndryshme për punët e gjelbërimit, lulet, rrethojat e gjalla, bari, etj •Lecka për pastrimin e dyshemesë •Sfungjerë (shpuzë) •Lecka për pastrimin e dritareve dhe mobilieve •Polir (shkëlqyes) për mobile •Polir (shkëlqyes) për metal dhe mesing •Lecka për pastrimin e dritareve •Polir për dysheme •Detergjent për qeramike •Detergjent për heqjen e njollave •Brusha për çpluhërosje (pastrimin e pluhurit) etj •Kocka dezinfektuese për urinare etj •Pajisje dhe makineri për pastrimin dhe sipas nevojë larjen e fasadës me të gjitha pjesë të përbërëse të saja si dritareve dhe elementeve tjera të pjesës së jashtme dhe brendshme të fasadës. Nr. Përshkrimi Nj. Matëse Sasia Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit të FSSH-sëm2 1,495.00 Në sipërfaqen prej 1,495.00 m2 hynë mirëmbajtja e objektivit, hapësirave të parkingut nëntokësor (garazheve), depos, mirëmbajtja e hapësirave të jashtme, të gjelbëruara, që çdo herë duhet pasur parasysh mirëmbajtjen prerjen e barit në çdo kohë (në sezonin dimëror të përdoren mjetet dimëror për pastrimin dhe shkrirjen e borës me kripë). Prandaj, marr per baze Aneksin 1 te FDT-se, vleresne e parashikuar nga AK dhe analizen financiar per kete AP lidhur me Nr. e punetreve, orarin dhe

listen e materialit shpenzues per kete AP cdo oferte financiare nen çmimin: 32,341.72 EURO, NUK ARRIN TI MBULOJ VETEM PAGATE E PUNETOREVE!?!...Sepse kjo kontrate eshte shërbime dhe OE nuk mund ti ikin TVSH me rastin e faturimit pran AK sepse keto jane rregullat nga Ligji mbi TVSH, dhe ja bejme me dije AK - ZPP (dhe jemi te sigurt se jane te vetijshem sepse nuk e kan AP te pere per kete natyre te sherbimeve) se e dim se TVSH nuk ka ne paga te punetoreve, por ketu eshte shërbimi i pastrimit dhe OE do detyrohen te leshojn faturen me TVSH pran AK dhe nese analizohet ashtu sic obligojn ligjet ne fuqi ne Republiken e Kosoves per kete AK dhe natyren e sherbimeve te kerkuara ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit cdo ofert nën vlerën totale: 32,341.72 Euro eshte e pa pergjegjshem dhe nuk plotëson kriteret e dosjes se tenderit dhe duhet te elemniohet ne kete AP, me posht po prezantojm tabele e analizes financiare: Provë: Analiza financiare sipas ligjive ne fuqi ne RKS:I. Paga bruto, neto dhe kontributet për një punëtor VEMENDJE/SQARIM PER ESH: AK-ZPP me rastin e refuzimit te KpR si te pa pabazuar me arsyetimin duke larguar fiolet qe jane ne dosie tendert ne ankesin 1 te FDT-se duke ja pershatuar nevojat e veta m efete veprim AK - ZPP ka ber shkelje te nenit 59 dhe 60 te LPP-se dhe nenin 40.6 dhe 40.7 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP, andaj ne kosiderojm se bazuar ne ankesin 1 specifikimi tekni dhe marr per baze Ligjin e Punes, kerkesen e pages per 3 puneotre atehere ashtu si ka dhen arsyetim ZPP perveq qe nuk plotëson pagat dhe shpenzimet OE i rekomanduar per kontrate shkele edhe Ligjin e Pune, Ligjin e procedures administrative dhe Detyrimore sepse marr per baze keto ligje shkele e Kriterin e përzgjedhjes pagen minimale neto 330 EURO, sepse kjo ka qene kerkes e dosies se tenderit si dhe referuar arsyetimit nga ZPP dhe specifikimit ne dosje tenderti aneksin 1 ne kputon ndryshe por AK ka kërkuar min (3) punetore dhe sipas kërkesës së AK (kurdo që paraqitet nevoja) e mirëmbajtjes higjienike dhe teknike, sanitare - dhe shtim të stafit sipas nevojës së AK pa pasur nevojë për mjete financiare shtesë. Prandaj 2 edhe 1 bejne 3 qe do kuptohet se AK ka kërkuar 3 punetore dhe ne rast nevoj mund te shtoj edhe punetore tjera pa mjete tjera shtese. Andaj kerkojm nga ESH dhe PSH te shqyrtojn drejt, dhe te thirren ne dispozite ligjore te LPP-se, duke trajtuar ne menyre te drejte transparente dhe funksion te parimit te prokurimit dhe qëllimin e tij ne menyre qe OE te mos diskriminohen dhe te trajtohen te favorizuar sepse OE i rekomanduar per kontrate eshte favorizuar nga AK nga inicimi i këtij AP. Te gjitha keto fakte dhe deshmi te ofruar nga ana jone jane profesional dhe nuk mund te kontestehoen nga ansje profesionist, prandaj arsyetimet e dhena nga AK jane arsytme jo te mbeshtetuar ne dispozita ligjore te LPP-se konkretisht nenet, 1, 6, 7, 52, 56, 59, dhe 60 te LPP-së. Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 59 te LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Pra duke i pasur parasysh te gjitha faktet ne lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti te prokurimit, rezulton se AK-ja ka rekomanduar per kontrate nje OE te papergjegjshem lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe ne kundërshtim me nenin 60 te LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara ne këtë dispozite. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1 , 2 , 6 , 7 , 52 , 56 , 59 par. 4 , 60 par.

1.1 , 72 të LPP-së, Neni 41 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Neni 17.23 deri 17.32 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Vendimin e OSHP lidhur me keto raste si koensitencë e vendimeve të PSH – OSHP, Neni 108/A të LPP-së. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u ceken me lartë, kërkojmë fillimisht nga ESH të nxjerr raport meritore të kthejë në rivlerësim - dhe pastaj nga PSH që të marrë: VENDIM të APROVOHET, si e bazuar ANKESA pranë OSHP-së e OE: N.N.P. “WENDA” – Vushtrri dhe të ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se B058 dhe lënda të kthehet në RIVLERESIM, Autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, në jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjitha palët që kanë marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: "Autoriteti Kontraktues, Ministria e Shëndetësisë i konsideron të pa bazuara pretendimet e juaja ankimore në lidhje me Njoftimin mbi vendimin e AK të datës 30.08.2024, për shpalljen e OE fitues në vlerën e ofertës 28,883.40 euro. Në Kërkesën tuaj për rishqyrtim ju kemi paraqitur analizën e juaj rreth kostos që sipas jush duhet të jetë minimumi 32,341.72 euro, me çrast ju si duket nuk e kemi vërejtur një detaj në specifikat e kërkuara teknike sipas Aneksit 1, ku AK-MSh mjaft qarte e ka specifikuar numrin e punëtorëve: Numeri i përgjithshëm i punëtorëve të cilët do të përfundojnë nga 8 orë në ditë do të jenë 2 (dy), do të jenë pastnës, ndërsa 1 (një) ose inë shuinë do të jetë inirënbajtës sipas kërkesës së AK (kurdo që paraqitet nevojë) e mirëmbajtjes higjienike dhe teknike, sanitare - dhe shtim të stafit sipas nevojës së AK pa pasur nevojë për mjete financiare shtesë. Nga kjo kërkesë e AK shihet qarte se kërkohej 2 (dy) punëtor pastrues me orar të rregullt të punës prej orës (7.00 - 15.00) për çdo ditë (e Hënë - e Premte), ndërsa 1 (një) ose më shumë mirëmbajtës sipas kërkesës së AK (kurdo që paraqitet nevojë). Sipas kësaj kërkesë të specifikat e AK, punëtori i tretë nuk është i përhershëm, por kërkohej (kurdo që paraqitet nevojë), andaj kalkulimi juaj mbi bazën e tre punëtorëve, është i gabuar. Sikur të kërkohej tre (3) punëtor të përhershëm atëherë nëse marrim parasysh edhe kostot ematerialit shpenzues hixhienik, edhe oferta juaj do të ishte në minimumin e çmimit të arsyeshëm, por në këtë rast kemi të bëjmë me dy punëtor të përhershëm e jo me tre, andaj ky dallim e mundëson që kompania të mbulojë kostot rreth materialit, tatimeve, fitimit dhe nevojat tjera siç janë kërkuar në Aneks 1. Nëse si AK-MSh kemi vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe pikërisht duke respektuar nenin 1 të LPP-se, me çrast oferta e rekomanduar është brenda përlllogaritjes së kërkuar për realizimin e kontratës, ndërsa oferta juaj është mbi 6,000.00 euro me e shtrenjte se sa OE i rekomanduar. OE i rekomanduar në ofertën e tij i ka ofruar deklaratat me shkrim në lidhje me pagat mujore neto prej 330.00 euro, si dhe deklaratën për pagesën e pagave me se largu deri me datën 05 të muajit në vijim, shih me poshtë deklaratat e OE në ofertën e dhënë."

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/09/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0833/24, ndërsa me datë 25/09/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0833 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertin shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues - " Eksperti sqaron se pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës,OE ankues të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së,për faktin se, oferta e tij renditet e katërta (4) apo e parafundit për nga çmimi si OE i përgjegjshëm (pasukseshëm) sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së. OE ankues në ankesën e tij ka paraqitur vetëm një pretendim ankimor dhe atë ndaj grupit të OE të rekomanduar për kontratë sa i përketë kalkulimit të pagave, ndërsa është pajtuar me Njoftimin mbi vendimin e AK-se sa ju përketë ofertave tjera të përgjegjshme (pasuksesshme) e që janë më të lira se sa oferta e OE ankues. Andaj edhe nëse aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim OE i rekomanduar për kontratë rezulton i përgjegjshëm me ofertën më të lirë në raport me OE ankues si dhe 2 oferta tjera të përgjegjshme me çmimin më të ulët se sa oferta e OE ankues."

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin konstatimeve të përkrahura në raportin e tij .

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve dhe rekomandimeve në

raportin e ekspertit shqyrtues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të hedhet si e pa lejuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që ankesa e OE të hedhet si e pa lejuar sepse i njëjti pas administrimit të shresave të lëndës ka vlerësuar se OE ankues *të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së*, për faktin se, oferta e tij renditet e katërta (4) apo e parafundit për nga çmimi si OE i përgjegjshëm (pasukseshëm) sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - N.N.P. Wenda**
- Arkivës së OSHP-së: